

**MEMORANDUMI I MIRËKUPTIMIT
NDËRMJET
ENTITETIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR BARAZINË GJINORE DHE
FUQIZIMIN E GRAVE
DHE
KOMUNËS SË LIPJANIT**

Ky Memorandum Mirëkuptimi (“MM”) lidhet mes Entitetit të Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (“UN Women”) dhe Komunës së Lipjanit (“Partneri”). UN Women dhe Komuna e Lipjanit referohen më poshtë si “Palë” dhe bashkërisht si “Palët”.

DUKE PASUR PARASYSH QË, UN Women është një organ në kuadër të Kombeve të Bashkuara i mandatuar për të arritur barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave;

DUKE PASUR PARASYSH QË, UN Women njih rëndësinë e bashkëveprimit dhe bashkëpunimin me partnerët për realizimin e mandatit dhe objektivave të veta strategjike;

DUKE PASUR PARASYSH QË, Partneri ka mandat që në mënyrë të pavarur të rregullojë dhe kryejë aktivitete me rëndësi lokale, të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale. Si i tillë, partneri kryen aktivitete në fushat e mëposhtme të kompetencës: planifikimi urban dhe rural, mbrojtja e mjedisit dhe natyrës, zhvillimi ekonomik lokal, aktivitetet komunale, kultura, sporti dhe rekreacioni, mirëqenia sociale dhe mbrojtja e fëmijëve, arsimit, kujdesi shëndetësor, fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, si dhe nga veprimtari të tjera të përcaktuara me ligj. Mandati i partnerit është në përputhje me angazhimin e UN Women për të ofruar mbështetje për qeveritë kombëtare dhe lokale për të zbatuar angazhimet kombëtare dhe ndërkombëtare për barazinë gjinore, në përputhje me ligjet kombëtare dhe dokumentet strategjike: Ligji Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore, Ligji Nr.05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024 të cilat përcaktojnë zotimet, objektivat dhe aktivitetet specifike për avancimin e barazisë gjinore dhe aplikimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në komunë.

DUKE PASUR PARASYSH QË, Partneri mbështet mandatin e UN Women siç përcaktohet në rezolutën 64/289 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara dhe Planin Strategjik të UN Women, dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar, veçanërisht Ligjin për Barazinë Gjinore, i cili e detyron Partnerin të respektojë parimin e mundësive të barabarta dhe të promovojë dhe përmirësojë barazinë midis grave dhe burrave duke marrë masa të përgjithshme dhe të veçanta. Në kuadër të kompetencave të tij, Partneri është i detyruar që në planet dhe buxhetet e tij strategjike të përfshijë parimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat, të zbatojë buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, si dhe të monitorojë efektet dhe ndikimin e programeve të tyre tek gratë dhe burrat dhe të raportojë çdo vit për progresin.

PËR RRJEDHOJË, Palët bien dakord të bashkëpunojnë për sa vijon:

Neni I

Objekti i Memorandumit të Mirëkuptimit

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi, së bashku me Shtojcat e mëposhtme që përbëjnë një pjesë integrale të tij, përcakton kushtet dhe afatet e bashkëpunimit mes Palëve:
 - a. Shtojca I: Përshkrimi i Aktiviteteve
 - b. Shtojca II: Kushtet e Përgjithshme të Bashkëpunimit ("Kushtet e Përgjithshme").
2. Ky Memorandum Mirëkuptimi dhe çdo marrëveshje e mëvonshme e lidhur në përputhje me të përbëjnë tërësinë e mirëkuptimit midis Palëve në lidhje me këtë objekt dhe zëvendësojnë çdo komunikim të mëparshëm me gojë ose me shkrim mbi këtë temë.

Neni II

Fushat e Bashkëpunimit

1. Palët bien dakord të bashkëpunojnë në mirëbesim me qëllim arritjen e objektivat të tyre të përbashkëta, të cilat janë:
 - a) Integrimi gjinor në programet vendore, zbatimi dhe monitorimi i tyre, nëpërmjet aplikimit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor si mjet dhe kryerjen e analizave gjinore nga stafi përkatës;
 - b) Fuqizimi i kapaciteteve të administratës komunale dhe përmbushja e zotimeve sipas Ligjit për Barazi Gjinore;
 - c) Avancimi i proceseve të planifikimit dhe programit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në nivel vendor;
 - d) Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave të ndara sipas gjinisë, raportimi dhe avancimi i statusit të grave dhe burrave në nivel lokal;
 - e) Sigurimi i pjesëmarrjes së qytetarëve dhe mekanizmave të konsultimit në nivel lokal duke marrë parasysh në mënyrë të barabartë nevojat e grave dhe burrave;
 - f) Shkëmbimi i përvojave në nivel kombëtar dhe rajonal dhe mësimi nga praktikatat e mira të vendeve të tjera në prezantimin e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor.
 - g) Themelimi i Task Forcës në udhëheqjen e kryetarit të komunës me qëllim të lehtësimit të aplikimit të Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor në nivel lokal.
2. Në vazhdim të objektivave të përbashkëta të përshkruara më sipër, Palët bien dakord të kryejnë aktivitetet e përcaktuara në Përshkrimin e Aktiviteteve ("Aktivitetet"), të cilat mund të modifikohen herë pas here me marrëveshje me shkrim nga Palët.

Neni III

Zbatimi i Memorandumit

1. Palët mund të negociojnë me mirëbesim termat e çdo marrëveshje(ve) të mëvonshme që mund të kërkohet për zbatimin e aktiviteteve. Këto marrëveshje do të përcaktojnë rolet dhe përgjegjësitë e secilës Palë dhe kostot ose shpenzimet që lidhjen me aktivitetet dhe mënyrën se si ato do të përballohen nga Palët. Këto marrëveshje do të përfshijnë kushtet e këtij Memorandumi me referencë.
2. Palët bien dakord që secila prej tyre të caktojë një menaxher të marrëdhënies për monitorimin dhe menaxhimin afatgjatë të kësaj marrëveshje. Gjithashtu, Palët mund të vendosin gjithashtu të formojnë grupe pune të përbërë nga përfaqësues të secilës Palë, që do të jenë përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e aktiviteteve.

Neni IV

Shkëmbimi i informacionit dhe dokumenteve

Palët bien dakord të shkëmbejnë informacionet dhe dokumentet përkatëse sipas nevojave për zbatimin e këtij Memorandumi, në varësi të kufizimeve dhe përcaktimeve që mund të kërkohen nga secila Palë për të mbrojtur natyrën konfidenciale të informacioneve dhe dokumenteve të caktuara.

Neni V

Njohja

1. Në varësi të paragrafit 4 (Përdorimi i emrit, shkurtesës dhe emblemës) të Kushteve të Përgjithshme, Palët mund të pranojnë dhe t'i bëjnë të ditur publikut këtë Memorandum si dhe informacione lidhur me aktivitetet, në pajtim me politikat aktuale të secilës Palë dhe me miratimin paraprak me shkrim të Palës tjetër.
2. Në aktivitetet publike, konferenca për shtyp ose mbledhje të çdo lloji, përfaqësuesit e secilës Palë mund të flasin për bashkëpunimin në lidhje me këtë Memorandum, por vetëm në emër të vet. Çdo njoftim për shtyp i njëanshëm nga Palët lidhur me këtë Memorandum ose aktivitetet e kryera në kuadër të tij do të ndahet me drejtuesin përgjegjës për komunikimin e Palës tjetër për të paktën pesë (5) ditë pune përpara publikimit.

Neni VI Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Palët do të bëjnë përpjekjet e tyre më të mira për të zgjidhur në mënyrë miqësore çdo mosmarrëveshje, polemik ose pretendim që lind nga ky Memorandum.
2. Çdo konflikt, mosmarrëveshje ose pretendim ndërmjet Palëve që buron nga ky Memorandum Mirëkuptimi, i cili nuk zgjidhet në përputhje me paragrafin e mësipërm, me kërkesën e secilës nga Palët, do të paraqitet një gjykatë prej tre arbitrash ("Tribunali"). Secila Palë do të emërojë një arbitër dhe dy arbitrat e emëruar në këtë mënyrë do të caktojnë një arbitër të tretë, i cili do të jetë kryesuesi i Tribunalit. Nëse, brenda 15 ditëve nga emërimi i dy arbitrave, arbitri i tretë nuk është caktuar, secila palë mund t'i kërkojë Presidentit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë të caktojë arbitrin e përmendur. Tribunali do të përcaktojë procedurat e veta, me kusht që çdo dy arbitra të përbëjnë një kuorum për të gjitha qëllimet dhe të gjitha vendimet do të kërkojnë miratimin e çdo dy arbitrash. Shpenzimet e Tribunalit do të përballohen nga Palët siç vlerësohen nga Tribunali. Vendimi i arbitrazhit do të përmbajë një deklaratë të arsyeve në të cilat bazohet dhe do të jetë I formës së prerë dhe detyrues për palët.
3. Pavlefshmëria ose moszbatueshmëria e një prej dispozitave të këtij Memorandumi nuk do të ndikojë në vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e dispozitave të tjera të tij.

Neni VII Njoftimet dhe adresat

Çdo njoftim në kuadër të këtij Memorandumi do të bëhet me shkrim dhe do të konsiderohet i kryer kur do t'i jetë dorëzuar palës në adresën e përcaktuar më poshtë:

Për UN Women: Alia El-Yassir,
Drejtoreshë Rajonale e UN Women e Evropës dhe Azisë
Qendrore
Abide-i Hürriyet Cad. İstiklal Sok. No: 11 KEY Plaza
Kat:8
34381 Şişli, Istanbul, Turkey

Për Komunën e Lipjanit: Imri Ahmeti
Kryetar i Komunës së Lipjanit
Rr. Shqipëria nr: 28, 14000 Lipjan, Kosovë

Neni VIII
Kohëzgjatja, Zgjidhja dhe Ndryshimi

1. Ky Memorandum Mirëkuptimi do të hyjë në fuqi me nënshkrimin nga të dyja Palët dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë prej dy vjetësh, përveç kur zgjidhjet paraprakisht nga njëra prej Palëve, në përputhje me paragrafin 2 më poshtë. Palët mund të bien dakord të zgjasin afatin e këtij Memorandum Mirëkuptimi për një periudhë të vazhdueshme dyvjeçare.
 2. Secila Palë mund ta zgjidhë këtë Memorandum Mirëkuptimi, në diskrecionin e saj, dhe do të njoftoj Palën tjetër me shkrim tre muaj përpara. Çdo marrëveshje e mëvonshme e lidhur në përputhje me këtë Memorandum Mirëkuptimi mund të zgjidhet në përputhje me dispozitën e zgjidhjes të parashikuara në këto marrëveshje. Në këtë rast, Palët do të ndërmarrin hapat e nevojshëm për të siguruar që aktivitetet në kuadër të kësaj MM-je dhe/ose ndonjë marrëveshje të mëvonshme, të përmbillen sa më shpejtë dhe me rregull.
 3. Dispozitat e mëposhtme do të vazhdojnë të ekzistojnë edhe pas përfundimit të këtij MM:
 - a) Neni IV (Shkëmbimi i Informacioneve dhe Dokumenteve), Neni VI (Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve);
 - b) Paragrafi 3 (Përgjegjësia), paragrafi 4 (Përdorimi i emrit, shkurtesës dhe emblemës), paragrafi 5 (Privilegjet dhe imunitetet) dhe paragrafi 10 (Pronësia Intelektuale) të Kushteve të Përgjithshme; dhe
 - c) Paragrafi 9 (Dëmshpërblimi) e Kushteve të Përgjithshme, nëse Partneri është një organizatë ndërqeveritare që nuk është pjesë e OKB-së.
 4. Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të ndryshohet me marrëveshje me shkrim mes Palëve
- NË DËSHMI TË SA MË SIPËR, përfaqësuesit e autorizuar të palëve vendosin nënshkrimet e tyre më poshtë.**

Për UN WOMEN:

Për KOMUNËN E LIPJANIT:

Alia El-Yassir
Drejtoreshë Rajonale e UN Women e
Evropës dhe Azisë Qendrore

Imri Ahmeti
Kryetar i Komunës së Lipjanit

Data

Data

Shtojca I: Përshkrimi i Aktiviteteve

Aktivitetet në kuadër të këtij Memorandumi do të realizohen në kuadër të Projektit të UN Women “Financimi Transformativ për Barazi Gjinore në Ballkanin Perëndimor (2020-2024)” financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim. Të gjitha aktivitetet do të realizohen në përputhje me rregulloret, rregullat dhe direktivat e UN Women.

Aktivitetet e përfshira në këtë MM janë si më poshtë:

- Vlerësimi gjinor i programeve të përzgjedhura vendore bazuar në të dhënat e ofruara nga partneri lokal, studimet përkatëse, intervistat dhe diskutimet në konsultim të ngushtë ndërmjet palëve.
- Kryerja e analizave gjinore të programeve të zgjedhura nga komuna me ndihmen e UN Women.
- Aplikimi i perspektivës gjinore dhe zhvillimi i masave specifike gjinore në programet dhe strategjitë lokale të Komunës, bazuar në rekomandimet që dalin nga vlerësimet gjinore nën mentorimin e ekspertëve lokale të angazhuara nga UN Women.
- Forcimi i kapaciteteve të zyrtarëve të administratës publike të përfshirë në planifikimin dhe buxhetimin e programit për integrimin e gjinisë në zhvillimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve dhe buxheteve përmes programeve standarde të orientimit, trajnimeve bazë dhe të avancuara për BPGJ dhe mbështetjes së vazhdueshme mentoruese të ofruar nga ekspertë të caktuar.
- Pjesëmarrja në ngjarje kombëtare dhe lokale për shkëmbimin e praktikave të mira dhe mësimet të nxjerra ndërmjet politikëbërësve dhe praktikuesve të buxhetit në nivel vendor mbi zbatimin e politikëbërjes dhe buxhetimit të përgjegjshëm gjinor.
- Promovimi i rrjetëzimit dhe vendosja e bashkëpunimit ndërkomunal për avancimin e barazisë gjinore dhe financimit të shërbimeve që u përgjigjen nevojave të grave dhe burrave në nivel lokal;

UN Women do të jetë përgjegjëse për:

- Zbatimi i drejtpërdrejtë i të gjitha aktiviteteve të përcaktuara në Përshkrimin e Aktiviteteve në bashkëpunim me Partnerin;
- Ofrimi i mbështetjes organizative dhe teknike për aktivitetet e mësipërme, në bashkëpunim me pikat kontaktuese të Komunës;
- Sigurimi i shkëmbimit të njohurive dhe informacionit ndërmjet komunës dhe pushteteve të tjera vendore që punojnë në avancimin e barazisë gjinore;
- Angazhimi i ekspertëve përgjegjës për trajnimin dhe mentorimin për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.

Komuna e Lipjanit do të jetë përgjegjës për:

- Sigurimi i të dhënave të disponueshme për kryerjen e analizave të programeve dhe buxheteve të përzgjedhura nga perspektiva gjinore;
- Lehtësimi i procesit të komunikimit për organizimin e intervistave dhe fokus grupeve dhe kryerja e rishikimit nga kolegët të draft vlerësimeve të prodhuara;
- Caktimi i dy pikave kontaktuese brenda komunës në 1) nivel të politikave që do të jenë përgjegjës për menaxhimin dhe vendimet e politikave dhe në 2) nivel teknik për koordinimin dhe udhëheqjen e aktiviteteve që dalin nga ky Memorandum;
- Zhvillimi i ndërhyrjeve vijuese dhe masave specifike gjinore për adresimin e rekomandimeve që rrjedhin nga analizat gjinore të programeve vendore;
- Sigurimi i pjesëmarrjes së përfaqësuesve komunalë nga administrata lokale dhe këshilli në aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve, aktivitetet përkatëse të projektit, duke përfshirë ngjarjet për shkëmbimin e praktikave të mira dhe mësimet e nxjerra ndërmjet politikëbërësve të nivelit lokal;
- Shpërndarja e materialeve dhe produkteve të njohurive të prodhuara në kuadër të projektit ndërmjet strukturave përkatëse vendore;
- Aktivitetet e PR lidhur me zbatimin e projektit në komunë.

Shtojca II. Kushtet e Përgjithshme të Bashkëpunimit

1. **Kontributi financiar:** Aktivitetet do të zbatohen në përputhje me rregulloret, rregullat, politikat dhe procedurat e secilës Palë, në varësi të disponueshmërisë së burimeve të nevojshme financiare. Çdo transferim fondesh ndërmjet Palëve do t'i nënshtrohet një marrëveshjeje të veçantë në përputhje me Nenin III.1 të Memorandumit të Mirëkuptimit.

2. **Statusi ligjor:**
 - a. Ky Memorandum Mirëkuptimi nuk do të interpretohet si krijimi i një partneriteti ligjor, sipërmarrje të përbashkët, krijimi i një marrëdhënie punësim, agjenci, marrëveshje ekskluzive apo i ndonjë marrëdhënie tjetër të ngjashme ndërmjet Palëve.
 - b. Asnjëra palë nuk gëzon të drejtën ose autoritet të lidhur kontratë ose të hyjë në një sipërmarrje në emër ose për llogari të Palës tjetër ose të krijojë apo të marrë përsipër detyrime të çfarëdo lloji, të shprehur apo të nënkuptuar, në emër të Palës tjetër, përveç nga se parashikohen shprehimisht në këtë Memorandum.
 - c. Përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet Palëve, Partneri ose kushdo tjetër i punësuar prej tij, nuk do të konsiderohet agjent ose zyrtar i UN Women dhe nuk gëzon të drejtën e shpërblimit ose rimbursimit.

3. **Përgjegjësia:** Çdo Palë do të jetë përgjegjëse për veprimet ose mosveprimet e veta.

4. **Përdorimi i emrit, shkurtesës dhe emblemës:** Asnjëra prej palëve nuk do të përdorë emrin, shkurtesën ose emblemën e Palës tjetër, të degëve dhe/ose filialeve të saj, pa miratimin paraprak të shprehur me shkrim nga Pala tjetër për çdo rast. Në asnjë rast nuk do të jepet autorizimi i emrit, shkurtesës ose emblemës së UN Women për qëllime tregtare apo për t'u përdorur në ndonjë mënyrë që sugjeron mbështetjen e produkteve apo shërbimeve të Partnerit nga ana e UN Women.

5. **Privilegjet dhe imunitetet:** Partneri do të respektojë statusin e UN Women si një organizatë ndërkombëtare publike e sistemit të Kombeve të Bashkuara. Ky Memorandum Mirëkuptimi nuk do të konsiderohet si heqje dorë, në mënyrë të shprehur apo të nënkuptuar, nga ndonjë prej privilegjeve dhe imunitetit të UN Women.

6. **Respektimi i ligjit:** Partneri do të respektojë ligjet e zbatueshme për të. Partneri nuk do të lejojë asnjë përfaqësues ose zyrtar të UN Women të marrë një përfitim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga ky Memorandum Mirëkuptimi apo nga ndonjë marrëveshje e mëvonshme ndërmjet Palëve.

7. **Kalimi i të drejtave dhe detyrimeve:** Partneri nuk do të kalojë, transferojë, premtojë apo të disponoj në mënyrë tjetër këtë Memorandum ose pjese të tij apo ndonjë prej të drejtave, pretendimeve apo detyrimeve të tij sipas këtij Memorandum, përveçse me miratimin paraprak

me shkrim të UN Women. Çdo kalim, transferim, premtim apo çdo disponim në formë tjetër I paautorizuar nuk do të jetë detyrues për UN Women.

- 8. Mos-heqja dorë:** Çdo heqje dorë e njëres pale, nga shkelja e një dispozite të këtij Memorandumi nuk do të kuptohet ose interpretohet si heqje dorë nga ndonjë shkelje tjetër e saj dispozite apo çdo shkelje e ndonjë dispozite tjetër të këtij Memorandumi. Moszbatimi I një dispozite të këtij Memorandumi nga njëra prej Palëve nuk do të nuk do të përbëjë heqje dorë nga ajo ose ndonjë dispozitë tjetër e këtij Memorandumi. Çdo heqje dorë duhet të jetë me shkrim dhe e nënshkruar nga Pala prej së cilës kërkohet zbatimi.
- 9. Dëmshtëpërblimi:** Nëse partneri është një organizatë ndërqeveritare që nuk është pjesë e OKB-së, nuk do ta ngarkojë me përgjegjësi, do ta mbrojë dhe dëmshtëpërblej UN Women kundër të gjitha padive, pretendimeve, kostove dhe përgjegjësi që rezultojnë nga çdo mosmarrëveshje tjetër që mund të lindin në kuadër të kësaj MM-je, si pasojë e veprimeve ose mosveprimet e Partnerit, agentëve ose punonjësve të tij.
- 10. Pronësia Intelektuale:** Ky MM nuk i jep asnjëres prej Palëve të drejtën për të përdorur materiale që i përkasin ose të krijuara nga Pala tjetër. Secila prej palëve do të ruajë të drejtat e pronësisë intelektuale mbi të gjitha materialet e hartuara dhe të prodhuara prej saj. Partneri njeh parimin që Organizata e Kombeve të Bashkuara ka pronësinë intelektuale të krijuar nga aktivitetet e programeve dhe projekteve të OKB-së për të mirën e përbashkët dhe se shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara kanë të drejtën e përdorimit jo tregtar të rezultateve të këtyre aktiviteteve të programeve dhe projekteve. Palët bien dakord që, përveç nëse parashikohet ndryshe në rregulloret, rregullat, politikat dhe procedurat e UN Women apo marrëveshjet e lidhura me qeveritë përkatëse pritëse dhe/ose partner zbatues, prona intelektuale e krijuar si rezultat i aktiviteteve do të menaxhohet në atë mënyrë që siguron qasjen më të gjerë të mundshme të publikut dhe që lejon përdorimin më të gjerë të mundshëm të tyre.